



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

Nr. 3296/1 Prot.

Tiranë, më 26.10.2021

Lënda: Mbi kërkesën për dhënien e pëlqimit për hyrjen menjëherë në fuqi të ligjit.

Drejtuar: **KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**
Znj. Lindita Nikolla, Kryetare

Tiranë

Për Dijeni: **KOMISIONIT PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**
Kuvendi i Shqipërisë

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT TË SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E REFORMAVE
Z. Arben Ahmetaj

MINISTRIT TË FINANCEVE DHE EKONOMISË
Znj. Delina Ibrahimaj

Tiranë

Përmes shkresës së Kuvendit me nr. 2393/1 prot., datë 18.10.2021, administruar pranë Institucionit të Presidentit të Republikës me nr. prot. 3296, datë 18.10.2021, jam njohur me kërkesën e arsyetuar të Kuvendit të Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të projektligjit “Për Eurobondin, që do të emetohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti, në marrëveshjet që do të lidhen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë”.

Sipas asaj që parashtrohet në këtë kërkesë, projektligji në fjalë është parashikuar të shqyrtohet në datën 25 tetor 2021 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe në seancën plenare të datës 28 tetor 2021¹.

¹ Referuar Vendimit nr. 74/2021, të Kuvendit “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për Eurobondin, që do të emetohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti, në marrëveshjet që do të lidhen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë””.

Nga shqyrtimi i kësaj kërkesë rezulton se, Qeveria shqiptare synon t'i drejtohet për herë të pestë tregjeve ndërkombëtare të kapitalit me instrumentin eurobond, për të siguruar një Eurobond në madhësi nga **500 deri 700 milionë euro**, dhe me maturim 7 deri 10 vjet, që sipas asaj që relatohet nga Këshilli i Ministrave në praktikën shoqëruese të projektligjit, ky instrument do të jetë në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit Publik.

Pas vlerësimit të plotë të kërkesës dhe praktikës shoqëruese të saj, komenteve lidhur me këtë procedurë të bëra nga Banka e Shqipërisë, si dhe pas ndjekjes me vëmendje të diskutimeve të këtij projektligji në Komisionin përgjegjës për Ekonominë dhe Financat në datën 25 tetor 2021², **Presidenti i Republikës jep pëlqimin e tij për hyrjen menjëherë në fuqi të ligjit, në rast të miratimit të këtij projektligji nga Kuvendi sipas kërkesave të nenit 84, pika 4, të Kushtetutës.**

Nga ana tjetër, duke i qëndruar në vijimësi shqetësimeve të ngritura nga Presidenti i Republikës, lidhur me nivelin e huamarrjes dhe borxhit publik, si dhe duke vlerësuar shqetësimet dhe kërkesat e ngritura nga diskutimet e deputetëve në shqyrtimin e këtij projektligji në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, vlerësoj tepër të nevojshme dhe kërkoj që, Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, duhet të sigurojnë një raportim që të sqarojnë para deputetëve dhe Seancës Plenare, në mënyrë shteruese lidhur me:

- Arsyet përse vijohet të ndiqet praktika e administrimit të financave të vendit me vendimmarrje të kësaj natyre, urgjente;
- Sqarimet përkatëse ndaj rritjes së huamarrjes së huaj, që duhet të trajtohet me kujdes ndaj rrezikut të kursit të këmbimit (shqetësim ky që është ngritur edhe nga FMN në raportin e tij të fundit);
- Të raportohet lidhur me performancën e borxhit publik;
- Të raportohet në terma krahasimorë skenari në rastin e një huamarrje në tregun e brendshëm, në raport me përdorimin e instrumentit të eurobondit;
- Analizë të plotë të kostos dhe përfitimit të marrjes hua në tregun e brendshëm (në lekë/në euro), apo në tregun e huaj, ose një kombinim i tyre;
- Një listim të saktë të projekteve që synohet të mbulohen me këtë shumë për të cilën po tentohet të dilet në Eurobond;

² Mbledhja e të cilit u transmetua drejtpërdrejtë:

<https://www.facebook.com/komisionieconomise/videos/1060054544833552/>

- Të evidentohet në mënyrë shumë më të qartë dhe transparente qëllimi i huamarrjes dhe mënyra e përdorimit të këtij fondi në vlera kaq të larta, veçanërisht nëse huamarrja synohet të përdoret për të financuar deficitin dhe borxhin e marrë, si dhe për t`u mbajtur rezervë në Thesar për mbështetje të ardhshme buxhetore, dhe jo për t`u injektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për ekonominë, siç përmendet jo qartë në relacionin shpjegues;
- Të sqarohet nëse huamarrja përmes këtij eurobondi, synon të shlyejë dhe huamarrjet e eurobondeve të mëparshme;
- Vendosjen në dispozicion të të gjithë deputetëve të Kuvendit, të gjithë praktikës dokumentare të kësaj iniciative;
- Të mbahen në vëmendje rekomandimet e Bankës së Shqipërisë, e cila gjykon se emetimi i këtij Eurobondi nuk cenon politikën monetare në afatin e shkurtër, megjithatë duhet patur kujdes në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Shqipëria është Republikë Parlamentare, e cila sipas Kushtetutës, njeh Kuvendin si organin më të lartë, përfaqësues të vullnetit të popullit dhe ushtrues të sovranitetit të deleguar prej tij. Kuvendi i Shqipërisë në respekt të parimeve të shtetit të së drejtës, ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duhet të monitorojë në mënyrë të vazhduar ekzekutivin në procesin e hartimit, propozimit dhe miratimit të nismave ligjvënëse, përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, mirëqeverisjen e vendit, mirëadministrimin dhe përdorimin sa më efikas të të mirave dhe financave publike, brenda së cilave përfshihet dhe vlerësimi dhe miratimi ose jo, i kësaj iniciative operacionale ligjore dhe financiare të Qeverisë për të dalë në treg përmes instrumentit të eurobondit.

Është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Kuvendit të Shqipërisë, që të vlerësojë dhënien ose jo të këtij autorizimi për Këshillin e Ministrave, ashtu sikundër është po përgjegjësia e Kuvendit që të monitorojë dhe kontrollojë Këshillin e Ministrave, jo vetëm për mënyrën dhe kushtet se si qeveria po del në treg përmes instrumentit të eurobondit, pra si do të ekzekutohet ky autorizim, por dhe për mënyrën se si këto fonde do të përdoren nga Qeveria, në çfarë formë do të projektohen dhe shpenzohen ato, duke stimuluar njëkohësisht rritjen e të ardhurave dhe rritjen ekonomike në vend.

Është pikërisht veprimtaria parlamentare, që do të duhet të kontrollojë Qeverinë, ashtu sikundër përmes miratimit të buxhetit të shtetit vit pas viti, të shpërndajë dhe autorizojë përdorimin e këtyre fondeve në mënyrën më të mirë, sipas nevojave reale të shoqërisë dhe në mbrojtje të interesit publik.

Për gjithë sa më sipër, Presidenti i Republikës përmes dhënies së pëlqimit vetëm për hyrjen në fuqi menjëherë të këtij ligji, me qëllim mos pengimin e mundësive për përdorimin e instrumentit të eurobondit sipas kushteve më të favorshme, i bën thirrje gjithë deputetëve të shqyrtojnë me shumë vëmendje këtë nismë para miratimit të saj, të konsiderojnë faktet, diskutojnë dhe vendosin me transparencë dhe përgjegjësi, kur kemi të bëjmë me një instrument që jo vetëm duhet trajtuar me kujdes, por edhe duhet përdorur me efikasitet për të mirën e ekonomisë së vendit.

Në përfundim, përsëris thirrjen që Qeveria dhe Kuvendi, në nisma të tilla ligjvënëse, të veprojnë në kohën e duhur, në mënyrë që t'u lihet hapësira e nevojshme të gjitha strukturave apo institucioneve për shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre.

Ju faleminderit,

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META